



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR

Nr. 1614/1 Prot

Shkodër, me dt. 26.10.2023

NJOFTIM

L ë n d a: *Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për lëvizje paralele në kategorinë drejtuese, pozicioni “Shef Sektori, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë”.*

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

KËSHILLIT TË GJYKATËS SË SHKALLË SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 “Për Organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Vendimit nr. nr.622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Shkresës nr. 1614 prot, datë 10.10.2023, për shpalljen e procedurës së lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë drejtuese, për pozicionin: **1 (një) pozicion – “Shef Sektori, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë**, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kategoria e ulët drejtuese III-2, ju njoftoj :

Në përfundim të verifikimit paraprak, për përmbushjen e kritereve, në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë drejtuese, në pozicionin “*Shef Sektori, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë*”, nuk u paraqit asnjë kandidaturë.

Procedura e lëvizjes paralele mbyllet pa asnjë kandidat.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër do të vijojë me procedurat e ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin drejtues “*Shef Sektori, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me*

Publikun, Median dhe me Jashtë”, sipas përcaktimeve dhe afateve të përshkuara në Shpalljen nr. 1614 prot, datë 10.10.2023.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

KANCELARE

Valbona SULEJMANI

